



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr: 238

**VENDIM**

**PËR LIRIM DHE EMËRIM TË SEKRETARIT TË KZAZ NR. 26, QARKU TIRANË,  
DHE ANËTARËVE TË DISA KZAZ-VE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenin 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V Ë R E N**

Në bazë të nenit 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia Demokratike, me shkresat nr.3697 prot., datë 13.04.2021, nr.3698 prot., datë 13.04.2021, ka kërkuar zëvendësimin e sekretarit të KZAZ nr. 26, Qarku Tiranë, anëtarëve të KZAZ nr. 26, Qarku Tiranë, KZAZ nr. 63, Qarku Berat.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresat nr.3695 prot., datë 13.04.2021, nr.3769 prot., datë 14.04.2021, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ nr. 2, Qarku Shkodër, anëtarit të KZAZ nr. 68, Qarku Berat.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, me shkresën nr.3635 prot., datë 12.04.2021, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ nr. 9, Qarku Kukës.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## **VENDOSA:**

1. Të liroj nga detyra sekretarin e KZAZ nr. 26, Qarku Tiranë, dhe anëtarët e disa KZAZ-ve, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Të emëroj sekretarin e KZAZ nr. 26, Qarku Tiranë, dhe anëtarët e disa KZAZ-ve, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen e KQZ-së dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3(tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

